



REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE

Numri i Ceshtjes : 31155-05217-80-2018 Data e Regjistrimit : 28/08/2018
Numri i Vendimit: 80-2018-4419 Data e Vendimit : 26/11/2018

VENDIM

NE EMER TE REPUBLIKES

GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE E PERBERE NGA:

GJYQTAR:{...}

SEKRETARE: {...}

Sot me date 26/11/2018mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore geshtjen civile qe i perket :

Padites Shoqeria {...} I Paditur DREJTORIA E PERGJITHSHME E PRONESISE INDUSTRIALE

Objekti:Ankim kunder vendimit nr. prot. 566/5, date 20/10/2017, te Bordit te Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale. Shfuqizimin e vendimit nr. nr. prot. 566/5, date 20/10/2017, te Bordit te Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale, me pasoje detyrimin e DPPI te pranoje kundershhtimin e regjistrimit te markes {...} (fjale dhe figure) me numer aplikimi AL/T/2015/566, date 02/09/2015 publikuar ne buletin e Pronesise Industriale nr.01/2016.

Baza Ligjore:Neni 7, 11/1, 15/a,17/a e vijues i Ligjit 49/2012 Nenet 31, 153 e vijues, neni 348 i K&X Neni 140, 143 pika 2/b, 143 pika 5/a, 152 dhe 153 te Ligjit nr. 9947, date 07/07/2008 VKM Nr. 1706, date 29/12/2008 "Per miratimin e rregullores per rregjistrimin e markave tregtare dhe te sherbimit" (te ndryshuar); Neni 113 e vijues i K. Pr. A

pranimin

VEREN :

Veren:

Pala paditese Shoqeria {...} i eshte drejtuar Gjykates Administrative te Shkalles se Pare, Tirane me padi kunder Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale me objekt shfuqizimin e vendimit nr. prot. 566/5, date 20/10/2017 te Bordit te Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale, me pasoje detyrimin e DPPI te pranoje kundershhtimin e regjistrimit te markes {...} (fjale dhe figure) me numer aplikimi AL/T/2015/566, date 02/09/2015 publikuar ne buletin e Pronesise Industriale nr.01/2016.

Nga shqyrtimi gjyqesor rezulton e provuar se Shoqeria {...} eshte shoqeri Italiane e njohur ne fushen e prodhimit dhe tregtimit te preparateve per perdorim fa{...}aceutik dhe veterinari, preparate sanitare per perdorim mjekesor.

Shoqeria {...} eshte pronar i markes "{...}" (fjale e figure) me numer regjistrimi 10586 mbrojtur ne Shqiperi prej dates 11.08.2005.

Shoqeria "R.M" sh.p.k., ka depozituar ne date 02 09 2015 prane DPPI, kerkesen me numer AL/T/2015/566 per regjistrimin e markes "{...}" - fjale dhe figure, per mallrat e klasave 05 dhe 08 te te

Klasifikimit te Nises: 5-Preparate veterinare, sanitare per perdorim mjekesor, desinfektante, preparate per shkaterrimin e parazitëve, fungicide, herbicide. 8-Spraj hinder mizave dhe te gjitha llojeve te tjera te insekteve."

Pala paditese shoqeria {...} ka paraqitur prane Bordit te Apelimit kundershhtimet e saj ne lidhje me rregjistrimin e kesaj marke.

Bordi i Apelimit i Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industrial me vendimin nr. 566/5 prot., date

20.10.2017 ka vendosur rrezimin e kundershhtimit te markes "{...}" (fjale dhe figure), me aplikant shoqerine {...} shpk dhe vijimin e regjistrimit te saj.

Ne keto kushte, pala paditese i eshte drejtuar gjykates me padine e mesipe{...}e. Pala paditese pretendon se marka qe kerkohej te rregjistrohet nga personi i trete eshte e ngjashme dhe krijon konfuzion me marken e rregjistruar. Marka e aplikuar perdor te njejtin koncept si marka e mepareshme, ku shfaqet numri 10 dhe elementi i lules se diellit, e cila eshte nje shenje identike me sprucuesin e luls se diellit tek sprucuesi {...}. Nga pikpamje fonetike shkronjat "H" dhe "A" nuk kane ndonje ndikim ne shqisat e degjimit tek konsumatorët sesa ka numri "10" qe shqiptohet i fundit. Ne kete koncept, nga pikpamja fonetike markat jane te ngjashme. Nga pikpamja konceptuale shenjat kane ngjashmeri dhe krijojne konfuzion. Ne menyren se si paraqiten markat nuk kane ndonje kuptim, pervec numrit "10", i cili ne perceptimin e konsumatorit shqiptar mund te nenkuptoje nje tregues te cilesise shume te mire ose ndikimit te larte qe pe{...}ban produkti. Ne keto kushte, perdorimi i numrit 10 cenon elementet dallues mes markave duke shkaktuar konfuzion. Markat e kundershhtuar synon te mbroje te njejten fushe te mallrave qe mbron edhe marka kundershhtuese. Ne keto kushte, pala paditese kerkon pranimin e padise.

Pala e paditur Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale dhe Avokatura e Shtetit pretenduan se e drejta e shoqerise {...} Shpk per te rregjistruar marken {...} mbeshtetet ne te drejta te fituara nga kjo shoqeri nje here e pergjithmone mbi marken {...} te rregjisitruar nga shoqeria {...} Shpk dhe te fituar me vendim gjyqesor. Marka {...} eshte nje variant teper i ngjashem me marken {...} te rregjisitruar me pare ne favor te pales se trete {...} Shpk.

Pala e trete Shoqeria {...} Shpk pretendoi se kerkese padia eshte jashte afatit, sepse vendimi i pales se paditur eshte marre qe me date 20.10.2017. pala paditese ka te mbrojtur vetem shkrimin {...} me nje pike uji ne ms, nderkohe qe shoqeria {...} Shpk ka te mbrojtur komplet bombulen Spraj me figure tre dimensionale dhe me karakteristike te shumeta dhe te vecanta te nuk kane lidhje me marken e mbrojtur te paditesit. Shoqeria {...} shpk eshte pronare e nje marke te rregjistruar tredimensionale me emertimin {...} ne nr.rregjistrimi kombetar 10921, me pamje pothuajse identike me marken tredimensionale te aplikuar {...}. Ne lidhje me marken tredimensionale {...}, pala paditese ka ngfritur padi ne lidhje me ngjashmerine e markave, por Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, me vendimin nr.8023 dt.17.10.2011 ka rrezuar kerkese padine me ane te se ciles kerkohej c'rregjistrimi i markes. Ky vendim eshte lene ne fuqi me vendimin nr.1002 dt.24.04.2012 te Gjykates se Apelit Tirane. Ne rastin konkret, marka tredimensionale {...} eshte nje variant pothuajse identik me marken e mepareshme tredimensionale {...}, ne pronesi te shoqerise {...} Shpk.

Nga shqyrtimi gjyqesor rezulton e provuar se shoqeria {...} (sot shoqeria {...}) ka ngritur padi kunder shoqerise {...} shpk dhe Drejtorise se Pergjithshme te Patentave dhe Markave me objekt shfuqizimin e markes tregtare {...} (fjale dhe figure) qe i perket rregjistrimit kombetar nr.10921 ne

emer te shoqerise {...} Shpk per shkak te konfuzionit qe shkakton tek publiku dhe detyrimin e shoqerise {...} Shpk qe te nderprerese perdorimin e metejshem te kesaj marke. Me vendimin nr.8023 dt.17.10.2011 Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane ka vendosur rrezimin e padise. Ky vendim eshte lene ne fuqi me vendimin nr.1002 dt.24.04.2012 te Gjykates se Apelit Tirane.

Shoqeria {...} I eshte drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me kerkese padi kunder shoqerise {...} SHpk, {...} Shpk dhe Drejtorise se Pergjithshme te Patentave dhe Markave me objekt konstatimin e konkurrences se pandershme nepe{...}jet rregjistrimit te kryer ne keqbesim dhe ndalimin e perdorimit te markes {...}, ne qarkullimin tregtar. Me vendimin nr.4488 dt.01.06.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane ka vendosur

rrezimin e kerkese padise sepse pretendimet ne lidhje me ngjashmerine e markave jane shqyrtuar me vendimin nr.8023 dt.17.10.2011 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane lene ne fuqi me vendimin nr.1002 dt.24.04.2012 te Gjykates se Apelit Tirane. Ky vendim eshte lene ne fuqi me vendim nr.2431 dt.23.11.2016 te Gjykates se Apelit Tirane. Gjykata pasi shqyrtoi ne teresi ceshtjen arriti ne konkluzionin se kerkese padia eshte pambeshtur ne ligj dhe ne prova dhe si e tille ajo duhet rrezuar.

Se pari, gjykata cmon se kerkese padia e ngritur nga pala paditese shoqeria {...} eshte brenda afatit te parashikuar nga neni 18 i ligjit nr.49/2012 dhe neni 184/g te ligjit nr.9947, date 07/07/2008, sepse nga pala e paditur dhe personi I trete nuk provohet ndonje date e sakte se kur pala paditese ka marre dijeni per vendimin nr. prot. 566/5, date 20/10/2017 te Bordit te Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale.

Konfo{...} nenit 18 te ligjit nr.49/2012, percaktohet se: *“1. Padia kunder veprimit administrativparaqitet ne gjykate brenda 45 diteve. Ky afat fillon nga: a) data e njoftimit, sipas menyres se percaktuar ne ligj, te aktit administrativ te organit epror, qe ka shqyrtuar ankimin administrative”*

Konfo{...} nenit 184/g te ligjit nr.9947, date 07/07/2008, percaktohet se: *“Kunder nje vendimi te Bordit te Apelit mund te behet ankim ne gjykatën kompetente brenda 45 diteve nga dita kur eshte marre njoftim per vendimin.”*

Ne rastin konkret, nga pala e paditur dhe pala e trete nuk provohet se kur eshte momenti qe pala paditese ka marre dijeni per vendimin nr.566/5prot. date 20/10/2017 te Bordit te Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale. Ne keto kushte, kjo gjykate vlereson se kerkese padia eshte brenda afateve te percaktuara nga neni 18 i ligjit nr.49/2012 dhe neni 184/g te ligjit nr.9947, date 07/07/2008.

Se dyti, kjo gjykate vlereson se nde{...}jet markes qe kerkohet te rregjistrohet nga shoqeria {...} Shpk, depozituar me date 02.9.2015 prane DPPI, sipas kerkeses me numer AL/T/2015/566 per regjistrimin e markes “{...}” - fjale dhe figure, per mallrat e klasave 05 dhe 08 te te Klasifikimit te Nises dhe markes se rregjistruar nga shoqeria {...} me nnumer rregjistrimi 10586 dt.11.08.2005 me emertimin {...} (fjale dhe figure) nuk krijohet ngjashmeri e cila te krijoje konfuzion ne treg.

Konfo{...} nenit 143 te ligjit nr.9947, dt.07.07.2008, *“Per pronesine intelektuale”, marka nuk mund te regjistrohet ose, nese eshte regjistruar, ajo duhet te deklarohet e pavlefshme kur: a) eshte e njejte me nje marke te meparshme dhe mallrat e sherbimet, per te cilat eshte aplikuar ose regjistruar ajo, jane identike me mallrat ose sherbimet, per te cilat eshte mbrojtur marka e meparshme; b) eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te meparshme, e cila mbrohet per mallra apo sherbime identike ose te ngjashme dhe kur, per shkak te njellojshmerise ose te ngjashmerise, ekziston mundesia e shkaktimit te konfuzionit te publiku, ku perfshihet edhe mundesia e bashkelidhjes me marken e meparshme; c) eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te meparshme, edhe kur eshte per t'u regjistruar ose eshte regjistruar per mallra apo sherbime, qe nuk jane te ngjashme me ato, per te cilat eshte regjistruar marka e meparshme, kur marka e meparshme ka nje reputacion ne Republiken e Shqiperise dhe perdorimi ose regjistrimi i markes ne fjale, pa shkak te arsyeshem, fiton prioritet te padrejte ose demton natyren dalluese apo emrin e mire te markes se meparshme.*

Gjykata vlereson se marka tredimensionale qe kerkohet qe te rregjistrohet nga shoqeria {...} Shpk, depozituar me date 02.09.2015 prane DPPI, sipas kerkeses me numer AL/T/2015/566 per regjistrimin e markes "{...}" - fjale dhe figure, per mallrat e klasave 05 dhe 08 te te Klasifikimit te Nises, eshte nje variant krejt I ngjashem i rregjistruar me pare nga kjo shoqeri markes tregtare tredimensionale {...} (fjale dhe figure) qe i perket rregjistrimit kombetar nr.10921 ne emer te shoqerise {...} Shpk.

Nga shqyrtimi gjyqesor rezulton e provuar se me vendimin nr.8023 dt.17.10.2011 Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane ka vendosur rrezimin e padise se Shoqerise Porta D'Oriente Spa (sot shoqeria {...}) ne lidhje me rregjist{...}in e markes tregtare tredimensionale {...} (fjale dhe figure) qe i perket rregjistrimit kombetar nr.10921 ne emer te shoqerise {...} Shpk. Ne ate vendim gjykata ka vleresuar se nuk ekzistojne kushtet e ngjashmerise dhe te konfuzionit ne lidhje me marken tregtare {...} te rregjistruar ne favor te pales paditese me ate te rregjistruar nga shoqeria {...} Shpk. Ky vendim eshte lene ne fuqi me vendimin nr.1002 dt.24.04.2012 te Gjykates se Apelit Tirane.

Po ashtu, me vendimin nr.4488 dt.01.06.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane ka vendosur rrezimin e kerkese padise se paraqitur nga Shoqeria {...} kunder shoqerise {...} Shpk me objekt konstatimin e konkurrences se pandershme nepe{...}jet rregjistrimit te kryer ne keqbesim dhe ndalimin e perdorimit te markes {...}, ne qarkullimin tregtar. Gjykata ka vendosur rrezimin e padise sepse pretendimet ne lidhje me ngjashmerine e

markave jane shqyrtuar me vendimin nr.8023 dt.17.10.2011 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane lene ne fuqi me vendimin nr.1002 dt.24.04.2012 te Gjykates se Apelit Tirane. Ky vendim eshte lene ne fuqi me vendim nr.2431 dt.23.11.2016 te Gjykates se Apelit Tirane.

Sa me siper, ne kushtet kur marka e depozituar me date 02.09.2015 prane DPPI, sipas kerkeses me numer AL/T/2015/566 per regjistrimin e markes "{...}" (fjale dhe figure) eshte nje variant krejt I ngjashem me marken e rregjistruar tredimensionale {...} (fjale dhe figure) qe i perket rregjistrimit kombetar nr.10921 ne emer te shoqerise {...} Shpk dhe ne kushtet kur kjo e fundit (marka e rregjistruar me nr.10921) nuk ka ngjashmeri dhe nuk krijon konfuzion me marken tregtare {...} te rregjistruar nga pala paditese me numer regjistrimi 10586 date 11.08.2005, vleresuar kjo nepe{...}jet vendimit gjyqesor te formes se prere nr.8023 dt.17.10.2011 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane lene ne fuqi me vendimin nr.1002 dt.24.04.2012 te Gjykates se Apelit Tirane, atehere kjo gjykate vlereson se nuk krijohen kushtet e ngjashmerise dhe te konfuzionit mes markes tredimensionale {...} (fjale dhe figure) te shoqerise {...} Shpk sipas kerkeses me numer AL/T/2015/566 me marken {...} me numer regjistrimi 10586 date 11.08.2005 te pales paditese shoqerise {...}. E drejta e shoqerise {...} Shpk per te rregjistruar marken tredimensionale {...} (fjale dhe figure) sipas kerkeses me numer AL/T/2015/566 mbeshtetet ne te drejta te fituara nga kjo shoqeri nje here e pergjithmone mbi marken tredimensionale {...} sipas rregjistrimit kombetar nr.10921.

PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar ne nenin 40 te ligjit nr.49/2012

Per keto arsye

Baza Ligjore:.

VENDOSI:

Vendosi:

-€€€€€€€ Rrezimin e kerkese - padise.

-€€€€€€€ Shpenzimet gjyqesore sic jane bere.

-€€€€€€€ Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën Administrative te Apelit, Tirane, brenda 15 diteve nga e nesermja e njoftimit te vendimit te aryetuar.

U shpall sot me dt.26/11/2018.

SHPENZIMET GJYQESORE

Kerkesepadia	0
Taksa Gjyqesore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

GJYQTAR:

{...}